

KUVENDI
PROJEK-TVENDIM

Nr. ____ 2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 74/2018 “PËR NGRITJEN E
KOMISIONIT TË PAVARUR PËR KOORDINIMIN, MONITORIMIN DHE NDJEKJEN
E ZBATIMIT TË LIGJIT NR.115/2016 “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT
TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, e Kushtetutës, të nenit 288 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe të nenit 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, me propozim deputeti.

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

1. Pika X e vendimit ndryshohet si më poshtë:
“Masa e Shpërblimit të anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” vendoset si më poshtë:
 - a. Kryetari i Komisionit të Pavarur për çdo mbledhje në të cilën është prezent, përfiton shpërblim në masën prej 30 përqind të pagës mujore bruto të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor/ Këshillit të Lartë të Prokurorisë sipas përcaktimeve të ligjit 115/2016 Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë,” dhe ligjit 96/2016, “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
 - b. Anëtarët Komisionit të Pavarur, për çdo mbledhje në të cilën janë prezent, përfitojnë secili shpërblim në masën prej 25 përqind të pagës mujore bruto të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor/ Këshillit të Lartë të Prokurorisë sipas përcaktimeve të ligjit 115/2016 Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe ligjit 96/2016, “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë;
 - c. Staf i Kuvendit që angazhohet me veprimtari në mbështetje të Komisionit të Pavarur, përfiton shpërblim mbi pagën në masën e vendosur nga Byroja e Kuvendit.”
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet që prej ditës së emërimit të anëtarëve të Komisionit të Pavarur.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën _____

RELACION

PËR PROJEKT-VENDIMIN PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 74/2018 "PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË PAVARUR PËR KOORDINIMIN, MONITORIMIN DHE NDJEKJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT NR.115/2016 "PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË"

Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", është ngritur dhe funksionon në bazë të Nenit 288 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"

Kuvendi me vendimin nr. 74/2018, ka miratuar me Vendim ngritjen e Komisionit të Pavarur, por pa parashikuar masën e shpërblimit për anëtarët e Komisionit dhe kryetarin. Administrata e Kuvendit hasi vështirësi në zbatimin dhe përcaktimin e masës së shpërblimit duke sjelle vonesa të pajustificueshme në raport me të zgjedhurit nga Kuvendi në këtë Komision.

Për këto arsye, propozoj ndryshimin e pikës X të vendimit dhe duke plotësuar vendimin edhe me dispozitat për masën e shpërblimit të anëtarëve të komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"

Propozimi mban në konsideratë volumnin e punës së Komisionit të Pavarur i cili konsiston në:

- a) monitorimin e proceseve të përzgjedhjes së kandidatëve dhe të zgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë;
- b) koordinimin midis institucioneve dhe organeve që zbatojnë ligjin nr. 115/2016 dhe ndjekjen dhe ecurinë e zbatimit të ligjit nga institucionet respektive, brenda afateve të përcaktuara ligjore;
- c) raportimin një herë në muaj në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për ecurinë e zbatimit të ligjit, si dhe sa herë është e nevojshme dhe kërkohet prej tij;
- d) raportimin në Kuvend për ecurinë e zbatimit të ligjit, sa herë kërkohet prej tij;
- dh) evidentimin e rasteve kur institucionet përgjegjëse nuk zbatojnë ligjin brenda afatit dhe nuk kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj, duke ia bërë me dije Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ose drejtpërdrejt Kuvendit, përfshirë dhe propozimin për marrjen e masave përkatëse për moszbatimin e ligjit.

Duke konsideruar fushën e veprimtarisë dhe organet që monitorohen nga Komisioni i Pavarur edhe propozimi për masën e shpërblimit, bëhet në referencë të nivelit të pagave të institucioneve dhe organeve të përfshira në fushën e monitorimit nga Komisioni i Pavarur.

Propozimi gjithashtu konsideron edhe karakterin e përkohshëm të Komisionit të Pavarur, i cili nëse reforma dhe ngritja e organeve të reja të drejtësisë ecën me ritmet e nisura, duhet ta perfundojë misionin brenda vitit në vazhdim.

Për sa më sipër propozohet si referim për shpërblimin për mbledhje, paga prej 30% dhe 25% të pagës mujore bruto të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor/ Këshillit të Lartë të Prokurorisë sipas përcaktimeve të ligjit 115/2016 Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë,"dhe ligjit 96/2016, "Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Ulsi MANJA

Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

KRYETAR

